

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje materiale pastrimi”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 39224300-1, 39830000-9, 39831200-8

Vlera e fondit limit: 2.489.920 (dymilion e katërqindetëdhjetenëntëmijë e nëntëqindnjëzetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 OE duhet të paraqesi vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM

nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”* nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

të ndryshuar ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullav etë prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për objektin e prokurimit, për artikujt në tabelën e mëposhtme. Në rast se, do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Nr. rendor sipas shtojcës nr. 7 te DT-së	Emërtimi i produktit
1	Solucion larës enësh lëng
2	Solucion larës dysHEMEJE (pLLAKASH)
3	Solucion larës xhamash
4	Sapun i lëngshëm
5	Solucion larës ËC dezinfektues
6	Solucion për pastrimin e smërçit/kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi
7	Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%
22	Ace pastrimi

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor”. Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për artikujt e specifikuar, lidhet drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë, origjinës dhe sigurisë së produkteve objekt prokurimi. Duke qënë se produktet e listuara, si solucionet larëse për enë, dysHEME dhe xhama, sapuni i lëngshëm, solucionet dezinfektuese për ËC, produktet për heqjen e smërçit dhe kriprave, si dhe substanca kimike si hipokloriti i natriumit dhe zbardhuesit, klasifikohen si produkte kimike me ndikim të drejtpërdrejtë në higjienën dhe shëndetin publik, është e domosdoshme që furnizimi i tyre të bëhet vetëm përmes kanaleve të sigurta dhe të autorizuar.

Ky kriter synon të sigurojë që operatori ekonomik ka një marrëdhënie të rregullt dhe të verifikueshme me prodhuesin ose me një distributor të autorizuar, duke garantuar kështu se produktet janë origjinale, përmbushin standardet teknike dhe ligjore në fuqi, si dhe janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës teknik dhe të sigurisë (si fletët e të dhënave të sigurisë, certifikatat e cilësisë, etiketimi sipas legjislacionit për kimikatet, etj.). Në rastet kur autorizimi paraqitet nga një distributor i autorizuar, kërkesa për të provuar lidhjen ndërmjet distributorit dhe prodhuesit është një element shtesë kontrolli që shmang ndërmjetësimet e paautorizuara dhe minimizon rrezikun e furnizimit me produkte të falsifikuara, të skaduar ose jashtë standardeve.

Ky kriter kontribuon në rritjen e besueshmërisë së zinxhirit të furnizimit dhe në sigurimin e vazhdimësisë së furnizimit gjatë zbatimit të kontratës, pasi operatorët e autorizuar kanë kapacitete më të mira për të garantuar disponueshmërinë e produkteve dhe mbështetjen teknike për përdorimin e tyre. Gjithashtu, ai ndihmon autoritetin kontraktor të reduktojë rreziqet që lidhen me performancën e produkteve, veçanërisht për artikuj që kanë funksion dezinfektues dhe kërkojnë përqendrim të sakta kimike, si hipokloriti i natriumit apo produktet zbardhuese, të cilat në mungesë të kontrollit të origjinës mund të paraqesin rrezik për përdoruesit dhe mjedisin. Ky kriter është një mekanizëm i domosdoshëm për të garantuar integritetin e procesit të prokurimit, cilësinë dhe sigurinë e produkteve, si dhe për të mbrojtur interesin publik përmes sigurimit të furnizimeve të besueshme dhe në përputhje me standardet përkatëse teknike dhe ligjore.

2.3.3 Operatori ekonomik për artikujt e renditur në tabelën e mëposhtëm duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi sipas pikes 2.3.2.

<i>Nr. rendor sipas shtojcës nr. 7 te DT-së</i>	<i>Emërtimi i produktit</i>
1	<i>Solucion larës enësh lëng</i>
2	<i>Solucion larës dysHEMEJE (pLLakash)</i>
3	<i>Solucion larës xhamash</i>
4	<i>Sapun i lëngshëm</i>
5	<i>Solucion larës ËC dezinfektues</i>
6	<i>Solucion për pastrimin e smërçit/kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi</i>
7	<i>Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%</i>
22	<i>Ace pastrimi</i>

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”, nenin 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM nr. 9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi për produktet e listuara lidhet drejtpërdrejt me garantimin

e sigurisë në përdorim, ruajtje dhe trajtim të produkteve kimike objekt prokurimi. Duke qenë se artikujt në fjalë, si solucionet larëse, dezinfektuesit, produktet për heqjen e smërçit dhe veçanërisht substanca si hipokloriti i natriumit dhe zbardhuesit, përmbajnë përbërës kimikë potencialisht të rrezikshëm, dokumenti MSDS është një instrument standard ndërkombëtar që siguron informacion të detajuar mbi përbërjen, rreziqet, masat mbrojtëse dhe procedurat emergjente që lidhen me këto produkte. Në aspektin teknik, MSDS i lëshuar nga prodhuesi garanton që informacioni mbi karakteristikat fiziko-kimike, klasifikimin e rrezikut, masat e ndihmës së parë, mënyrat e trajtimit në rast aksidenti, kushtet e ruajtjes dhe transportit, si dhe udhëzimet për asgjësimin e sigurt, është i saktë, i përditësuar dhe në përputhje me standardet dhe legjislacionin përkatës për kimikatet. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për produkte që përdoren në ambiente të përbashkëta ose institucione, ku ekspozimi i përdoruesve dhe stafit ndaj substancave kimike duhet të kontrollohet në mënyrë rigorozë. Kërkesa që MSDS të jetë i lëshuar nga prodhuesi, dhe jo nga burime të tjera, siguron besueshmërinë dhe autenticitetin e të dhënave, duke shmangur rrezikun e informacionit të pasaktë ose të paplotë që mund të çojë në përdorim të gabuar të produkteve. Gjithashtu, kjo kërkesë mundëson verifikimin e përputhshmërisë së produkteve me standardet e sigurisë dhe me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, duke ndihmuar autoritetin kontraktor në vlerësimin objektiv të ofertave. Disponueshmëria e MSDS për secilin produkt i jep autoritetit kontraktor dhe përdoruesve fundorë mundësinë për të hartuar dhe zbatuar procedura të qarta për përdorimin e sigurt, trajnimin e stafit, si dhe reagimin në raste incidentesh, duke reduktuar në mënyrë të ndjeshme rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin. Në të njëjtën kohë, ky kriter kontribuon në përmbushjen e detyrimeve ligjore që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe me administrimin e substancave kimike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike, për artikujt e listuar si më poshtë:

<i>Nr. rendor sipas shtojcës nr. 7 të DT-së</i>	<i>Emërtimi i produktit</i>
<i>1</i>	<i>Solucion larës enësh lëng</i>
<i>2</i>	<i>Solucion larës dysHEMEJE (pLLAKASH)</i>
<i>3</i>	<i>Solucion larës xHAMASH</i>
<i>4</i>	<i>Sapun i lëNGSHËM</i>
<i>5</i>	<i>Solucion larës ĚC dezinfektues</i>
<i>6</i>	<i>Solucion për pastrimin e smërçit/kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi</i>
<i>7</i>	<i>Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%</i>
<i>14</i>	<i>Letër higjienike e paketuar (min 10 rulon/paketim)</i>
<i>22</i>	<i>Ace pastrimi</i>

Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e NSHP-së Himarë, në adresën: pranë stadiumit, Himarë.

Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.

Mostrat duhet të markohen me numrin rendor sipas shtojcës nr. 7 (Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit) të dokumenteve të tenderit.

Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë mostra për produktet e specifikuar mundëson verifikimin praktik dhe të drejtpërdrejtë të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Duke qenë se artikujt në fjalë përfshijnë produkte me përdorim të përditshëm dhe ndikim të drejtpërdrejtë në higjienë, pastrim dhe dezinfektim, si dhe produkte konsumi si letra higjienike, vlerësimi vetëm mbi bazën e dokumentacionit teknik nuk është gjithmonë i mjaftueshëm për të garantuar cilësinë reale të tyre. Paraqitja e mostrave krijon mundësinë për autoritetin kontraktor që të kryejë një vlerësim të detajuar fizik dhe funksional të produkteve, duke analizuar elementë të tillë si përbërja, konsistenca, efikasiteti në përdorim, aroma, paketimi, etiketimi, si dhe karakteristika të tjera specifike që lidhen me performancën e tyre në kushte reale. Për produkte kimike si solucionet larëse dhe dezinfektuesit, mostrat lejojnë verifikimin e vetive bazë funksionale dhe përputhshmërinë me kërkesat teknike, ndërsa për produkte si letra higjienike mundësohet vlerësimi i cilësisë fizike, rezistencës dhe përbërjes. Detyrimi që mostrat të paraqiten në ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës dhe në vendin e përcaktuar garanton barazi trajtimi dhe transparencë ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke siguruar që të gjitha ofertat të vlerësohen në të njëjtat kushte dhe brenda të njëjtit afat kohor. Po ashtu, kërkesa që mostrat të jenë të markuara sipas numrit rendor të përcaktuar në dokumentet e tenderit lehtëson identifikimin dhe shmang çdo paqartësi gjatë procesit të vlerësimit teknik. Përcaktimi i qartë se mostrat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike përkatëse siguron që operatorët ekonomikë të paraqesin produkte reale që korrespondojnë me ofertën e tyre dhe jo variante të ndryshme apo të përmirësuara vetëm për efekt demonstrimi. Kjo kontribuon në ruajtjen e integritetit të procesit dhe në parandalimin e praktikave abuzive. Kërkesa për paraqitjen e mostrave është një instrument thelbësor për verifikimin praktik të cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve, duke rritur transparencën,

objektivitetin dhe sigurinë e procesit të prokurimit, si dhe duke mbrojtur interesin publik përmes përzgjedhjes së produkteve që përmbushin standardet e kërkuara teknike dhe funksionale.

2.3.5 Operatori ekonomik i cili deklarohet prodhues i detergjentëve brenda Republikës së Shqipërisë, sipas pikës 2.3.2 të kapacitetit teknik, duhet të paraqesë leje mjedisore të prodhuesit në zbatim të Ligjit Nr. 10.448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar. Ai duhet të disponojë dhe të paraqesë: lejen e mjedisit të tipit A ose të tipit B , kategoria për ndikim në mjedis, me kod III.I.C ose III.1.B për aktivitetin në fushën e veprimtarisë së prodhimit të produkteve të pastrimit/detergjenteve, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 76 dhe 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 40 pika 5/a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”. Autoriteti kontraktor përveç kërkesave të parashikuar në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter përbën një kriter thelbësor teknik dhe ligjor që lidhet drejtpërdrejt me garantimin e përputhshmërisë së aktivitetit prodhues me standardet mjedisore në fuqi. Duke qenë se prodhimi i produkteve të pastrimit dhe detergjentëve përfshin përdorimin e substancave kimike dhe procese që mund të kenë ndikim në mjedis, kontrolli përmes pajisjes me leje mjedisore është një mekanizëm i domosdoshëm për të siguruar që ky aktivitet zhvillohet në mënyrë të kontrolluar dhe të sigurt. Ky kriter garanton që operatori ekonomik ka kaluar një proces vlerësimi nga autoritetet kompetente për ndikimin e aktivitetit të tij në ajër, ujë, tokë dhe në shëndetin e njeriut. Kjo përfshin vlerësimin e emetimeve, shkarkimeve, menaxhimit të mbetjeve, përdorimit të lëndëve të para dhe masave për minimizimin e ndotjes, duke siguruar që prodhimi i detergjentëve realizohet në përputhje me standardet mjedisore dhe teknologjitë e lejuara. Kërkesa që kjo leje të jetë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit siguron vlefshmërinë ligjore dhe verifikueshmërinë e dokumentit, duke garantuar që operatori ekonomik është i regjistruar dhe i autorizuar për të ushtruar aktivitetin përkatës në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo rrit transparencën dhe besueshmërinë e operatorit, si dhe mundëson verifikimin institucional të të dhënave të paraqitura në kuadër të procedurës së prokurimit. Ky kriter siguron që autoriteti kontraktor të lidhë kontratë vetëm me operatorë që respektojnë detyrimet ligjore në fushën e mjedisit dhe që operojnë në mënyrë të qëndrueshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për produkte që përdoren gjerësisht dhe që, nëse prodhohen pa standardet e duhura, mund të shkaktojnë ndotje mjedisore ose rreziqe për shëndetin e përdoruesve. Kërkesa për paraqitjen e lejes mjedisore për prodhuesit vendas të detergjentëve është një garanci e domosdoshme për përputhshmërinë ligjore dhe mjedisore të aktivitetit prodhues, duke siguruar që produktet e ofruara vijnë nga subjekte që operojnë në përputhje me standardet e kërkuara dhe që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

2.3.6 Operatori ekonomik i cili paraqitet si tregëtues i detergjentëve, sipas pikës 2.3.2 të kapacitetit teknik, për produktet të cilat prodhohen brenda Republikës së Shqipërisë, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se prodhuesi i këtyre detergjentëve, në zbatim

të ligjit Nr.10.448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar, disponon, lejen e mjedisit të tipit A ose të tipit B, kategoria për ndikim në mjedis, me kod III.I.C ose III.1.B për aktivitetin në fushën e veprimtarisë së prodhimit të produkteve të pastrimit/detergjenteve, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Bisnesit (QKB).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 76 dhe 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 40 pika 5/a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”. Autoriteti kontraktor pwrvec kwrkesave tw parashikuaranë këtë nen, mund tw përcaktojë kriteret të tjera të vecanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa që operatori ekonomik, i cili paraqitet si tregtues i detergjentëve, të paraqesë një deklaratë përmes së cilës konfirmon se prodhuesi i produkteve të ofruara, në rastet kur ato prodhohen brenda Republikës së Shqipërisë, disponon leje mjedisore në përputhje me Ligjin Nr. 10.448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, përbën një kriter të rëndësishëm teknik dhe ligjor që synon të garantojë përputhshmërinë e të gjithë zinxhirit të furnizimit me standardet mjedisore në fuqi. Ky kriter është veçanërisht i domosdoshëm në rastet kur operatori ekonomik nuk është vetë prodhues, por furnizohet nga palë të treta, duke e bërë të nevojshme sigurimin e një garancie të qartë mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e aktivitetit prodhues. Kjo deklaratë shërben si një instrument vetëdeklarimi me përgjegjësi ligjore, përmes së cilit operatori ekonomik merr përsipër të vërtetojë se prodhuesi i detergjentëve përmbush kërkesat për pajisje me leje mjedisore të tipit A ose B, sipas kategorive të ndikimit në mjedis me kodet përkatëse III.I.C ose III.1.B, që lidhen me aktivitetin e prodhimit të produkteve të pastrimit dhe detergjentëve. Kjo nënkupton se edhe pse operatori nuk e ushtron drejtpërdrejt aktivitetin prodhues, ai garanton se furnizohet nga subjekte që operojnë në përputhje me standardet mjedisore dhe rregullat ligjore përkatëse.

Kërkesa që leja mjedisore të jetë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit siguron një nivel të lartë besueshmërie dhe verifikueshmërie institucionale, duke garantuar që prodhuesi është i regjistruar dhe i autorizuar për të ushtruar aktivitetin në mënyrë të ligjshme. Për më tepër, kjo kërkesë krijon një lidhje të qartë përgjegjësie midis tregtuesit dhe prodhuesit, duke e bërë operatorin ekonomik përgjegjës për saktësinë e informacionit të deklaruar dhe për përzgjedhjen e furnitorëve që përmbushin standardet ligjore. Ky kriter ndihmon autoritetin kontraktor të sigurohet që edhe në rastet e furnizimit indirekt, produktet e ofruara nuk burojnë nga aktivitete të paligjshme ose që nuk respektojnë kërkesat mjedisore. Ky kriter përbën një mekanizëm të domosdoshëm kontrolli dhe transparence, i cili garanton që i gjithë zinxhiri i furnizimit është në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe standardet teknike, duke mbrojtur interesin publik dhe duke siguruar furnizime të qëndrueshme dhe të ligjshme.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë 1 (një) automjet (ATP) për transportin e mallrave, të cilat duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Për mjetin e kërkuar duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

a) Nëse është në pronësi, të disponohet certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik e vlefshme, polica e vlefshme e sigurimit të detyrueshëm të mjetit.

b) Nëse është me qira/ huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik e vlefshme, si dhe polica e vlefshme e sigurimit të detyrueshëm të mjetit.

Shënim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara më sipër do të paraqiten nga OE i suksesshëm, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me aftësinë reale të operatorit për të realizuar në mënyrë të rregullt dhe të sigurt furnizimin objekt kontrate. Duke qenë se produktet e kërkuara përfshijnë detergjentë dhe produkte higjieno-sanitare, të cilat në shumë raste klasifikohen si produkte kimike që kërkojnë kushte të caktuara transporti, disponimi i një mjeti të përshtatshëm është i domosdoshëm për garantimin e integritetit të tyre gjatë gjithë zinxhirit të shpërndarjes. Në aspektin teknik, kërkesa për një automjet të dedikuar për transport mallrash siguron që operatori ekonomik ka kapacitetet minimale për të përmbushur detyrimet kontraktuale në kohë dhe sipas kushteve të kërkuara, duke shmangur varësinë nga palë të treta të pakontrolluara që mund të ndikojnë në cilësinë dhe afatet e furnizimit. Përcaktimi që mjeti mund të jetë në pronësi ose me qira/huapërdorje reflekton një qasje proporcionale dhe jo diskriminuese, duke lejuar pjesëmarrjen e një game më të gjerë operatorësh ekonomikë, ndërkohë që ruhet kërkesa për disponueshmëri efektive të mjetit gjatë zbatimit të kontratës. Dokumentacioni i kërkuar për mjetin, si certifikata e pronësisë ose kontrata e qirasë/huapërdorjes, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik dhe polica e sigurimit të detyrueshëm, shërben për të verifikuar statusin ligjor dhe gjendjen teknike të automjetit, duke garantuar që ai është i autorizuar për qarkullim, i sigurt për përdorim dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për transportin e produkteve që mund të kenë kërkesa specifike për ruajtje dhe që, nëse transportohen në kushte të papërshtatshme, mund të dëmtohen ose të humbasin vetitë e tyre funksionale. Shënimi që ky kriter konsiderohet i përmbushur përmes vetedeklarimit në fazën e ofertimit, me detyrimin që dokumentacioni i plotë të paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i suksesshëm përpara shpalljes së fituesit, përfaqëson një mekanizëm të balancuar që lehtëson pjesëmarrjen dhe redukton barrën administrative për operatorët në fazën fillestare, duke ruajtur njëkohësisht mundësinë për verifikim të plotë nga autoriteti kontraktor përpara finalizimit të procedurës. Ky mekanizëm kontribuon në rritjen e efikasitetit të procesit të prokurimit dhe në sigurimin e një vlerësimi të drejtë dhe transparent.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës si më poshtë:

ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Specifikimi i Materialeve:

Nr.	Emërtimi i produktit	Specifikimet teknike
1	Solucion larës enësh lëng	Me efekt pastrimi të thellë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe të ketë analizën spektrale në etiketë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm3 deri në 1.2 gr/cm3. Lënda tensioaktive të jetë

		nga deri në 20%. parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10. 15%
2	Solucion larës dysHEMEJE (pLLAKASH)	me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ -1.1 gr/cm ³ . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. I përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Ambalazhimi në bidon plastik me konfeksione sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
3	Solucion larës XHAMASH	me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%.
4	Sapun i lëngshëm	ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se gr/cm ³ . Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1
5	Solucion larës dezinFEKTUES	Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të ËC. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ deri në 1.1 gr/cm ³ . Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.
6	Solucion për pastrimin e smërçit/kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi	Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitarët. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
7	Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%	ku përmbajtja e klorit aktiv të jetë 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo më shumë se 5%, të mos ketë përmbajtje të lëndëve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të çelët, me erën karakteristike shpuesë

		në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastik të përshtatshëm që ti rezistojnë efektit shpues të “klorit”. Ambalazhimi të jetë i etiketuar ku të paraqitet titulli i klorit aktiv. Të jetë cilësor.
8	Fshesë pastrimi pa bisht	Fshesa të jetë me fije të dendura, të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm. Të jetë për pastrim të ambienteve të brendshme. Të jenë rezistente gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vendi i vendosjes së shkopit të jetë standard. Pesha e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr.
9	Shtupë për larje dysHEMEJE	përbërë nga fibra tekstili me përbërje pambuku që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T’i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.
10	Furça për pastrimin e ËC-së	të jetë me fije të forta sintetike. Furçë për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shume se 300 gr.
11	Lecka për larje xhamash (përmasa 32 x 32 cm)	Lecka të jetë me material mikrofibër, e përbërë me 80% poliestër dhe 20% poliamid.
12	Lecka për larje xhamash (përmasa 38 x 38 cm)	Lecka të jetë me material mikrofibër, e përbërë me 80% poliestër dhe 20% poliamid.
13	Letër guzhine e paketuar (10m)	Letra të jetë e paketuar, standard me rula. Të jetë cilësore. Të jetë 10 m dhe të jetë me shkëputje.
14	Letër higjienike e paketuar (min 10 rulon/paketim)	Të jetë me paketim min 10 rulon/pako, 3 fije, pesha 120÷140 gr/rulon, lartësia e rulonit 9.5÷10cm, gjatësia e rulonit jo më e vogël se 25m, nr. i ndarjeve 235÷255, fletëpalosje zig-zag me shkëputje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë.
15	Letra të lagura higjienike për të rritur (min 100 fije/pako)	me aromë natyrale, e përdorshme për higjienën min 100 fije/pako, për bebe dhe të rritur. Të jetë e testuar dermatologjikisht, ti përshtatet pH të lëkurës.
16	Kosh plastik për hedhjen e mbeturinave (5 litër)	të jetë në formë drejtkëndore ose rrethore, me kapak nga sipër që hapet si dritare. Kapaciteti mbajtës i koshit të jetë me volum min 5 Litër.
17	Kovë pastrimi e thjeshtë për shtupë (5 litër)	Të jetë e thellë dhe të ketë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës. Kapaciteti mbajtës i kovës të jetë me volum min 5 Litër.
18	Qese mbeturinash (35 litër)	Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 35 litër dhe të përmbajë min 15 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jenë të

		paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
19	Qese mbeturinash (240 litër)	Të jetë material i trashë, masa 90x120, madhësia e tyre të mundësoj grumbullimin e mbeturinave të përmasave të ndryshme, kapaciteti 240 lt,
20	Qese mbeturinash (120 litër)	Të jetë material i trash, masa: 70x105, madhësia e tyre të mundësoj grumbullimin e mbeturinave të përmasave të ndryshme. Të jetë e paketuar në forëm rulo me minimumi 10 fije dhe vëllim 120 litër
21	Qese mbeturinash (60 litër)	Të jenë të paketuara në formë ruloje me min 15 fije dhe vëllim min 60 litër. Pakoja e paketuar në formë ruloje. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
22	Ace pastrimi	Pa spërkatje, lëng me i trashë se zbardhuesit tradicional. Zbardhuesi Ace me sistemin e kursimit të fibrave që mbron pëlhurat nga dëmtimi i zverdhjes. Kapaciteti: 2.5 lt. Paketimi: 1 cope
23	Thasë të mëdhenj (Big Bag)	Thes i madh dhe i fortë, bërë për të mbledhur mbetje të ndryshme, mban ngarkesë deri në 1000 kg, me ngjyrë e bardh, me rripa.
24	Lecka për larje xhamash (përmasa 32 x 32 cm)	Leckat të jenë me material microfibrë, e përbër me 80% polyester dhe 20% poliamid
25	Lecka për larje xhamash (përmasa 38 x 38 cm)	Të jetë cilësore, e përshtatëshme për pastrimin e mobiljeve të ndryshme, me aftësi super thithëse, të jenë me ambalazhim min 3 fije /pako
26	Furça për pastrimin e ËC-së	të jetë me fije të forta sintetike. Furçë për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shume se 300 gr.
27	Letra të lagura higjienike për të rritur (min 100 fije/pako)	Me aromë natyrale, e përdorshme për higjen, min 100 fije /pako, për bebe dhe të rritur. Të jetë e testuar dermatologjikisht,ti përshtatet pH të lëkurës.
28	Sfungjer enësh i thjeshtë	të jenë të përdorshëm për pastrim pjatash, tenxheresh dhe kazanësh. Të jenë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjete teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra.
29	Doreza Latex ose Nitrile	josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimshe, në masat XS, S, M, L, XL (sipas kërkesës së punonjësve), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimumi 100 copë/pako. Të ketë çertifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.
30	Maskë kirurgjikale e thjeshtë	me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojnë hundën dhe gojën, me përshtatës për hundën, të mos shkaktojnë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshekueshmëri të mirë të ajrit,

		me nivel filtrimi të ajrit $\geq 99\%$, hipoalergjike, me copë të pathurur me 3 shtresa me palosje, celuloze, poliestër, fibër, me formë drejtkëndëshe e sheshtë, me nivel të mirë mbrojtje, me dimensione 90mm x 180mm (± 10 mm). Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.
31	Fshesë merimangash me shkop	Fshesa për pastrimin e merimangave, të jetë e përbërë me fije të dendura e të buta plastike me gjatësi mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme. Bishti të jetë i gjatë jo më i shkurtër se 100 cm, i përbërë nga materiali metalik i veshur me një shtesë plastike. Fshesa dhe shkopi të kenë mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim.

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i produktit	Njësia matëse	Sasia
1	Solucion larës enësh lëng	500 ml	70
2	Solucion larës dysHEMEJE (pllakash)	litër	300
3	Solucion larës xhamash	750 ml	100
4	Sapun i lëngshëm	500 ml	250
5	Solucion larës EC dezinfektues	litër	200
6	Solucion për pastrimin e smërçit/kriprave nga hidrosanitare me mekanizëm sprucimi	litër	100
7	Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%	litër/kg	100
8	Fshesë pastrimi pa bisht	copë	50
9	Shtupë për larje dysHEMEJE	copë	100
10	Furça për pastrimin e EC-së	copë	70
11	Lecka për larje xhamash (përmasa 32 x 32 cm)	copë	150
12	Lecka për larje xhamash (përmasa 38 x 38 cm)	copë	150
13	Letër guzhine e paketuar (10m)	Rulon	150
14	Letër higjienike e paketuar (min 10 rulon/paketim)	pako	250
15	Letra të lagura higjienike për të rritur (min 100 fije/pako)	pako	100
16	Kosh plastik për hedhjen e mbeturinave (5 litër)	copë	50
17	Kovë pastrimi e thjeshtë për shtupë (5 litër)	copë	50
18	Qese mbeturinash (35 litër)	pako	1.000
19	Qese mbeturinash (240 litër)	pako	1.500
20	Qese mbeturinash (120 litër)	pako	1.500
21	Qese mbeturinash (60 litër)	pako	1.000
22	Ace pastrimi	litër	400
23	Thasë të mëdhenj (Big Bag)	copë	100

24	Lecka për larje xhamash (përmasa 32 x 32 cm)	copë	150
25	Lecka për larje xhamash (përmasa 38 x 38 cm)	copë	150
26	Furça për pastrimin e ËC-së	copë	80
27	Letra të lagura higjienike për të rritur (min 100 fije/pako)	pako	100
28	Sfungjer enësh i thjeshtë	copë	50
29	Doreza Latex ose Nitrile	pako	50
30	Maskë kirurgjikale e thjeshtë	copë	200
31	Fshesë merimangash me shkop	copë	30

Afatet e lëvrim:

7 (shtatë) ditë kalendarike nga lidhja e kontratës. Ky afat është vlerësuar si i mjaftueshëm për realizimin e kontratës me sukses nga operatori ekonomik i suksesshëm.

Specifikimet teknike të përcaktuara për produktet objekt prokurimi janë hartuar mbi bazën e kërkesave funksionale, kimike dhe fizike që lidhen drejtpërdrejt me efektivitetin në përdorim, sigurinë për përdoruesin dhe përputhshmërinë me standardet e cilësisë për produkte higjieno-sanitare dhe materiale ndihmëse pastrimi. Për produktet detergjente, përcaktimi i parametrave si përqindja e lëndëve tensioaktive, vlera e pH-së, densiteti dhe tretshmëria në ujë është thelbësor për të garantuar performancën pastruese dhe njëkohësisht për të shmangur efektet e dëmshme mbi sipërfaqet dhe shëndetin e përdoruesve. Për shembull, kufizimi i pH-së në intervale të caktuara siguron që produktet të jenë efektive ndaj papastërtive, por pa qenë tepër agresive, ndërsa përmbajtja e kontrolluar e tensioaktivëve garanton balancën midis fuqisë pastruese dhe sigurisë mjedisore. Po ashtu, kërkesa për homogjenitet, viskozitet dhe aromë lidhet me stabilitetin fizik të produktit dhe përvojën e përdorimit, duke siguruar që produkti të jetë i njëtrajtshëm dhe funksional gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

Për produkte specifike si hipokloriti i natriumit dhe zbardhuesit, specifikimet mbi përmbajtjen e klorit aktiv, alkalitetin dhe mungesën e papastërtive të ngurta janë kritike për garantimin e efektit dezinfektues dhe për shmangien e rreziqeve gjatë përdorimit dhe ruajtjes. Ambalazhimi në materiale rezistente ndaj veprimit kimik dhe etiketimi i saktë janë elementë të domosdoshëm për sigurinë në transport dhe përdorim, si dhe për identifikimin e produktit dhe gjurmueshmërinë e tij. Në mënyrë të ngjashme, kërkesa për mekanizma sprucimi apo forma të veçanta ambalazhimi për disa produkte lidhet me lehtësinë e aplikimit dhe rritjen e efikasitetit në pastrim, veçanërisht në zona të vështira si hidrosanitare.

Për artikujt jo kimikë, si mjetet e pastrimit dhe materialet konsumuese, specifikimet janë të orientuara drejt qëndrueshmërisë, funksionalitetit dhe ergonomisë në përdorim. Parametra si pesha, përbërja materiale, dimensionet dhe rezistenca mekanike janë të rëndësishëm për të siguruar që këto produkte të përballojnë përdorimin e vazhdueshëm dhe të ofrojnë efikasitet në punë. Për shembull, përdorimi i mikrofibrës në leckat e pastrimit garanton aftësi të lartë thithëse dhe pastrim pa lënë gjurmë, ndërsa përbërja e shtupave dhe furçave ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e pastrimit dhe jetëgjatësinë e tyre.

Specifikimet për produktet e higjienës personale dhe mbrojtëse, si dorezat dhe maskat, janë të ndërtuara mbi kërkesa që lidhen me sigurinë biologjike, komoditetin dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë certifikime të njohura dhe kushte për paketim që parandalojnë kontaminimin. Po ashtu, përcaktimi i afatit minimal të skadencës siguron që produktet të jenë funksionale dhe të sigurt gjatë periudhës së përdorimit nga autoriteti kontraktor.

Në tërësi, këto specifikime teknike synojnë të krijojnë një standard të qartë dhe të matshëm për cilësinë e produkteve, duke mundësuar një vlerësim objektiv të ofertave dhe duke garantuar që produktet e furnizuara të përmbushin kërkesat funksionale, të jenë të sigurt për përdoruesit dhe të qëndrueshme në përdorim. Përmes këtij përcaktimi të detajuar, minimizohen rreziqet që lidhen me furnizimin e produkteve jo cilësore, duke mbrojtur interesin publik dhe duke siguruar një nivel të lartë të performancës në përdorimin e tyre.

Specifikimet teknike përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

NJËSIA E PROKURIMIT